



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 781/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15.12.2017 shqyrtoi ankesat përkatësisht me:

Objekt:

“Shfuqizim i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Shpresa” sh.p.k. & “Dion Texnikh A.E.”, në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-21386-07-18-2017, me objekt “Shërbimi i pastrimit të zonës Tirana III”, me fond limit 494.683.652 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 27.09.2017 nga autoriteti kontraktor, Bashkia e Tiranës.

Shfuqizim i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Alko Impex General Constrection” d.sh.h. në procedurën e mësipërme e prokurimit”.

“Shfuqizim i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e operatorit ekonomik “Victoria Invest” sh.p.k. nga procedura e mësipërme e prokurimit”.

“Shfuqizim i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Alko Impex General Constrection” d.sh.h. në procedurën e mësipërme e prokurimit”.

Ankimues: Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Shpresa” sh.p.k. & “Dion Texnikh A.E.”
Bulevardi “Gjergj Fishta”, Kulla nr. 2, Tiranë

“Victoria Invest” sh.p.k.
Lagja “28 Nëntori”, Rruga “11 Nëntori”, Elbasan

Autoriteti Kontraktor: Bashkia e Tiranës
Sheshi “Skënderbej”, Nd. 2, Kodi Postar 1001

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010 “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.4. Kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 19.07.2017, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me nr. REF-21386-07-18-2017, me objekt “*Shërbimi i pastrimit të zonës Tirana III*”, me fond limit 494.683.652 lekë (pa TVSH).

II.2. Në datën 27.09.2017, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët referuar dokumentacionit të autoritetit kontraktor, kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Pastime Silvio” sh.p.k.
& “Er.Cav” Srl 440.306.450,1 lekë, skualifikuar
2. “Victoria Invest” sh.p.k. 455.120.199 lekë, skualifikuar
3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Shpresa” sh.p.k.
& “Dion Texnikh A.E.” 460.308.404,40 lekë, skualifikuar
4. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Korsel” sh.p.k.
& “Brai Cata” Srl 470.663.330,29 lekë, skualifikuar
5. “Alko Impex General Contrustion” d.sh.h. 473.765.974 lekë, kualifikuar
6. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Be – Is” sh.p.k.
& “Sea” Srl & “Egland” sh.p.k. 484.329.326 lekë, skualifikuar
7. “Fusha” sh.p.k. 492.006.962 lekë, skualifikuar
8. “Infinit Construction” sh.p.k. 492.710.902 lekë, skualifikuar
9. “Rej” sh.p.k. 493.969.649 lekë, skualifikuar

II.3. Në datën 20.10.2017, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Shpresa” sh.p.k. & “Dion Texnikh A.E.” është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

• *Operatori ekonomik “Shpresa” shpk nuk plotëson pikën 2 të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: “Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të shërbimit të pastrimit për Zonën Tirana – III, i cili duhet të ketë një eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet në fushën e ofrimit të shërbimit të pastrimit shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme: Librezë pune (përkatëse), Diplomë , CV përkatëse, Kontrate pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme). Në rast të mosplotësimit në këtë kontratë të eksperiencës 5 vjeçare të punës së kërkuar më sipër, Drejtuesi Teknik duhet të paraqesë vërtetim lëshuar nga punëdhënësi i mëparshëm për eksperiencën e punës në ofrimin e shërbimit të pastrimit, pasi CV rezulton e panënshkruar nga Drejtuesi Teknik.*

• *Operatori ekonomik “Shpresa” shpk nuk plotëson pikën 4 të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: “Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar 1 (një) mjek të përgjithshëm dhe duhet të rezultojë në list-pagesat e shoqërisë. Kjo duhet të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve: Kontratë Pune e vlefshme, Urdhër Mjeku, CV, Librezë Pune, Diplomën përkatëse.*

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të ketë të punësuar 1 (një) mjek të përgjithshëm i cili duhet të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë dhe ta vërtetojë me dokumentacionin e mësipërm”, pasi CV rezulton e panënshkruar nga Mjeku i Përgjithshëm.

• Operatori ekonomik “Shpresa” shpk nuk plotëson pikën 12, gërma “e” të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: “Mjetet e porositura duhet të shoqërohen me Akt Marrëveshjen e porosisë/Kontratën e Porosisë (origjinal ose kopje e noterizuar). Akt Marrëveshja e porosisë/Kontrata e Porosisë duhet të përmbajë të dhënat e sakta në lidhje me tipin e mjetit të porositur, vitin e prodhimit të tij, të dhënat teknike për mjetin, kushtet e kontratës si dhe afatin për ekzekutimin e porosisë. Akt Marrëveshja e porosisë/Kontrata e Porosisë duhet të shoqërohet dhe me katalogun e mjetit të porositur (origjinal ose kopje e noterizuar)”, pasi për mjetet e porositura nëpërmjet kontratës së porosisë me subjektin “Autovision” (IVECO), Nr. 6190.Rep, Nr.3056. Kol, datë 17.09.2017 në katalogët e paraqitur jepen të dhëna vetëm për kokën e makinerive dhe jo pjesën e karrocërës së tyre, pra materiali viziv i paraqitur nuk përmban të dhëna teknike/specifikimet cka bie në kundërshtim me pikën 11 (a-f).

II.3.1. Në datën 27.10.2017, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Shpresa” sh.p.k. & “Dion Texnikh A.E.”, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar arsyet e skualifikimit të tij të dhëna nga autoriteti kontraktor, si edhe duke ngritur pretendime në lidhje me operatorët ekonomikë të kualifikuar. Konkretisht ankimuesi pretendon si më poshtë vijon:

Oferta jonë është skualifikuar me pretendimin se:

- 1. Operatori ekonomik “Shpresa” sh.p.k. nuk plotëson pikën 2 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga administrator i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të shërbimit të pastrimit për Zonën Tirana – II, i cili duhet të ketë një eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet në fushën e ofrimit të shërbimit të pastrimit shuqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm: Librezë pune (përkatëse), Diplomë, CV përkatëse, Kontratë pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme). Në rast të mosplotësimit në këtë kontratë të eksperiencës 5 vjecare të punës së kërkuar më sipër, Drejtuesi Teknik duhet të paraqesë vërtetim lëshuar nga punëdhënësi i mëparshëm për eksperiencën e punës në ofrimin e shërbimit të pastrimit, pasi CV rezulton e panënshkruar nga Drejtuesi Teknik.*
- 2. Operatori ekonomik “Shpresa” sh.p.k. nuk plotëson pikën 4 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar 1 (një) mjek të përgjithshëm dhe duhet të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë. Kjo duhet të vërtetohet me paraqitjen e dokumentave: Kontratë Punë e vlefshme, Urdhër Mjeku, CV, Librezë Pune, Diplomën përkatëse. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të ketë të punësuar 1 (një) mjek të përgjithshëm i cili duhet të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë dhe ta vërtetojë me dokumentacionin e mësipërm, pasi CV rezulton e panënshkruar nga Mjeku i Përgjithshëm.*

Në lidhje me motivacionin e skualifikimit se CV e Drejtuesit Teknik dhe e mjekut është e panënshkruar konstatojmë se në asnjë pikë të DST nuk është kërkuar që CV të jenë të firmosura.

Gjithashtu, nuk ka asnjë akt, rregull apo referencë ligjore si në Shqipëri ashtu edhe në të gjitha vendet e tjera që parashikon detyrimin ligjor të firmosjes së CV nga ana e personit përkatës. Sa më sipër pretendimi i KVO nuk qëndron.

3. Operatori ekonomik "Shpresa" sh.p.k. nuk plotëson pikën 12, germa "e" të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderi: "Mjetet e porositura duhet të shoqërohen me Akt Marrëveshjen e porosisë/Kontratën e Porosisë (origjinal ose kopje e noterizuar). Akt Marrëveshja e porosisë/Kontrata e porosisë duhet të përmbajë të dhënat e sakta në lidhje me tipin e mjetit të porositur, vitin e prodhimit të tij, të dhënat teknike për mjetin, kushtet e kontratës si dhe afatin për ekzekutimin e porosisë. Akt Marrëveshja e porosisë/Kontratat e Porosisë duhet të shoqërohet dhe me katalogun e mjetit të porositur (origjinal ose kopje e noterizuar), pasi që mjetet e porositura nëpërmjet Akt-Marrëveshjes së Porosisë me subjektin "Autovision" (IVECO), datë 17.09.2017 në katalogët e paraqitur jepen të dhëna vetëm për kokën e makinerive dhe jo pjesën e karrocërisë së tyre, pra materiali viziv i paraqitur nuk përmban të dhëna teknike/specifikimet cka bie në kundërshtim me pikën 11 (a-f).

Për sa i përket përmbushjes së pikës 11 (a-f) kemi paraqitur akt-marrëveshje porosie me shoqërinë "Autovision" sh.a., një kompani serioze e cila ka ekskluzivitetin e IVECO në Shqipëri. Në pikën 3 të kësaj Akt marrëveshje porosie thuhet se shoqëria "Autovision" sh.a. merr përsipër sigurimin e këtyre mjeteve sipas kërkesave të cilat do të blihen nga shoqëria "Shpresa" sh.p.k. dhe "Dion Texnikh AE" para fillimit të kontratës dhe pika b) të gjitha mjetet do të jenë në përputhje me të dhënat teknike dhe specifike. Janë paraqitur katalogët për secilin mjet të porositur, gjithashtu edhe një deklaratë nga shoqëria "Autovision" e firmosur, vulosur nga administrator ku sqaron për secilin katalog se kujt mjet i përket.

Ky format katalogësh është standart dhe u vihet në dispozicion vetëm distributorëve të autorizuar të IVECO që në këtë rast është shoqëria "Autovizion" sh.a. Ju sqarojmë se katalogët e paraqitur janë të vetmit katalogë që IVECO disponon për mjetet e reja, të cilët i janë vënë në dispozicion vetëm shoqërisë "Shpresa" sh.p.k. dhe "Dion Texnikh AE" për këtë procedurë prokurimi. Pretendimi i KVO-së se në katalogët e paraqitur jepen të dhëna vetëm për kokën e makinerive dhe jo pjesën e karrocërisë së tyre nuk qëndron pasi katalogët e paraqitur përmbajnë të dhëna teknike për secilin mjet të porositur ku jepet gjatësia, gjërësia, pasha maksimale e ngarkesës (Max body and Payload) etj.

Në asnjë pikë në DST nuk është kërkuar që katalogët të kenë detyrimisht materialin viziv të mjetit të porositur. Shoqëria "Shpresa" sh.p.k. ka paraqitur katalogun teknik për secilin mjet. Gjithashtu kemi paraqitur 3 katalogë shtesë ku i përmbajnë në mënyrë vizive të gjitha mjetet e kërkuara. Mjafton të hyni në faqen IVECO dhe me emërtimet e secilit katalog Daily, Neë Stralis, Neë Eurocargo, Neë Trakker Hi Land dallohen qartë se kujt mjet i përkasin.

Neni 27, pika 6 e VKM 914 [...] parashikohet shprehimisht se: Autoriteti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentat e tenderit, si: a) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike.

Duke marrë shkas dhe nga një vendim i KPP nr. 131, datë 15.03.2017 ju sqarojmë se katalogët janë document i nxjerrë nga prodhuesi dhe jo nga operatori ekonomik pjesëmarrës, çka do të thotë që një katalog mund të përmbajë shumë produkte të ndryshme apo të natyrave të ndryshme, por e rëndësishme për autoritetin kontraktor është që të krijojë bindjen se operatori ekonomik ofertues është në kushtet e përmbushjes së kriterëve kualifikuese për realizimin me sukses të kontratës. Akoma më tej, autoriteti kontraktor mund të kërkonte sqarime nga ofertuesi në kuptim të nenit 53, pika 4 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Përsa më lart, katalogët teknikë të paraqitur si dëshmi, përmbajnë të dhënat e nevojshme dhe të mjaftueshme për të gjitha mjetet e kërkuara e në tërësi japin garanci për autoritetin kontraktor në përmbushjen me sukses të objektivit të prokuruar, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit. Nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur vërtetojmë se kemi të gjitha mundësitë dhe kapacitetet për të realizuar kontratën në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor.

Duke vazhduar më tej, në bazë të nenit 62 “Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës” të LPP autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm për vetë cilësimin e tij ligjor si autoriteti me interes dhe me përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës[...]

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës prandaj pretendimet e KVO-së edhe në këtë rast nuk mund të shërbejnë si shkak për skualifikimin e ofertës sonë pasi arsyeja për të cilën jemi skualifikuar është lehtësisht e verifikueshme në momentin e kontrollit fizik të mjeteve sipas pikës 12 (g) ku Autoriteti kontraktor rezervon të drejtën që Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga shpallja e fituesit të kryejë verifikimin fizik të mjeteve sipas specifikimeve teknike të deklaruara në procedurën e prokurimit.

Referuar kësaj arsyeje për skualifikim, a është mbajtur i njëjti qëndrim me operatorët e tjerë pjesëmarrës me katalogët e paraqitur prej tyre?

Në dijeninë tonë, operatorët e kualifikuar në këtë procedurë kanë pasaktësi apo mangësi të mjeteve në katalog.

Në kuadër të parimit të trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe mosdiskriminimit të tyre, autoriteti kontraktor duhet të mbajë të njëjtën linjë gjykimi dhe qëndrimi, pasi për fakte të njëjta nuk mund të veprojnë në mënyra të ndryshme duke skualifikuar një operator ekonomik dhe duke kualifikuar tjetrin.

Autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë ka skualifikuar ofertën e Shpresa sh.p.k. që i kursen shtetit një vlerë prej 13.457.570 lekë dhe ka kualifikuar në kundërshtim me rregullat e prokurimit dy operatorët e tjerë që kanë mangësi në dokumentacion për sa i përket kriterëve të veçanta të kualifikimit “Kapaciteti teknik”.

Pra nuk e plotësojnë nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin public”, i ndryshuar, ku parashikohet “[...]”

Përsa më sipër argumentuam, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin public”, dhe DST kërkojmë:

- *Pezullimin e procedurës derisa ankesa jonë të jetë shqyrtuar plotësisht*
- *Kërkojmë kualifikimin e ofertës tonë që plotëson të gjitha kriteret kualifikuese, që të shpallemi ofertë fituese, pasi kemi paraqitur çmimin më të ulët nga oferta tjetër e kualifikuar duke i kursyer shtetit vlerën prej 13.457.570 lekë.*

II.3.2. Në datën 06.11.2017, me shkresën nr. 39217/2 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues, duke mos e pranuar ankesën e tij.

II.3.3. Në datën 08.11.2017 bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, nëpërmjet të cilës kundërshton skualifikimin e ofertës së tij, si edhe kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik të kualifikuar.

II.4. Në datën 20.10.2017 operatori ekonomik “Victoria Invest” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, për arsye si më poshtë vijon:

- *Operatori ekonomik “Victoria” shpk nuk plotëson pikën 11 të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme...”, pasi nuk është paraqitur një deklaratë mbi disponueshmërinë ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë e mjeteve të kërkuara.*

- *Operatori ekonomik “Victoria” shpk nuk plotëson pikën 12, të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: “Për Mjetet teknologjike të kërkuara në pikën 11, gërma a – f, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë.....”, pasi në dokumentacionin bashkëlidhur kontratës së shitjes me kusht me subjektin “Gentek Lojistik temizlik Makin eve Endustriyel Urunler A.S”, nuk ekziton asnjë lidhje pronësie mbi mjetet nga ana e shitësit, subjektit “Gentek Lojistik temizlik Makin eve Endustriyel Urunler A.S”.*

- *Operatori ekonomik “Victoria” shpk nuk plotëson pikën 12, të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: “Për Mjetet teknologjike të kërkuara në pikën 11, gërma a – f, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë.....”, pasi në kontratën e shitjes me kusht me subjektin “Gentek Lojistik temizlik Makin eve Endustriyel Urunler A.S”, Nr.588.Rep, datë 27.09.2017 nuk është përcaktuar specifikisht objekti i procedurës së prokurimit, konkretisht:” Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana III”.*

- *Operatori ekonomik “Victoria” shpk nuk plotëson pikën 12, të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: “Për Mjetet teknologjike të kërkuara në pikën 11, gërma a – f, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë.....”, pasi referuar kontratës së porosisë me subjektin “Autovision” (IVECO), Nr. 581.Rep, datë 26.09.2017 dhe kontratës së shitjes me kusht me subjektin “Gentek Lojistik temizlik Makin eve Endustriyel Urunler A.S”, Nr.588.Rep, datë 27.09.2017, nga verifikimi i dokumentacionit bashkëlidhur rezulton paraqitja e mjeteve të njëjta nga dy subjekte të ndryshme, e dëshmuar me të njëjtat foto.*

• Operatori ekonomik “Victoria” shpk nuk plotëson pikën 12, gërma “e” të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: “Mjetet e porositura duhet të shoqërohen me Akt Marrëveshjen e porosisë/Kontratën e Porosisë (original ose kopje e noterizuar). Akt Marrëveshja e porosisë/Kontrata e Porosisë duhet të përmbajë të dhënat e sakta në lidhje me tipin e mjetit të porositur, vitin e prodhimit të tij, të dhënat teknike për mjetin, kushtet e kontratës si dhe afatin për ekzekutimin e porosisë. Akt Marrëveshja e porosisë/Kontrata e Porosisë duhet të shoqërohet dhe me katalogun e mjetit të porositur (original ose kopje e noterizuar)”, pasi për mjetet e porositura nëpërmjet kontratës së porosisë me subjektin “Autovizion” (IVECO), Nr. 581.Rep, datë 26.09.2017 në katalogët e paraqitur jepen të dhëna vetëm për kokën e makinerive dhe jo pjesën e karrocërisë së tyre, pra materiali viziv i paraqitur nuk përmban të dhëna teknike/specifikimet cka bie në kundërshtim me pikën 11 (a-f).

II.4.1. Në datën 25.10.2017, operatori ekonomik “Victoria Invest” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar arsyet e skualifikimit të tij të dhëna nga autoriteti kontraktor, duke pretenduar si më poshtë vijon:

I.

Shoqëria jonë gjykon se autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë ka skualifikuar operatorin ekonomik “Victoria Invest” sh.p.k. në kundërshtim me dispozitat e prokurimit publik, me kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DST dhe me të gjithë praktikën e deritanishme të prokurimeve publike dhe brenda afatit ligjor po ju paraqesim ankesën tonë.

Shoqëria jonë ka paraqitur në tender të gjithë dokumentacionin e kërkuar në DST, ka paraqitur gjithashtu deklaratën për specifikimet teknike dhe gjithashtu deklaratë për kontrollin e mjeteve me specifikimet përkatëse nga momenti i shpalljes së fituesit. Në deklaratën e paraqitur në tender nga ana e shoqërisë tonë i kemi dhënë të drejtë AK që të verifikojë disponueshmërinë e mjeteve gjatë verifikimit fizik në cdo moment të kërkuar në AK, madje kemi deklaruar edhe adresën e saktë të vendndodhjes së mjeteve. Disponueshmërinë e mjeteve AK të të gjithë operatorëve ekonomikë, AK ka të drejtën ta bëjë gjatë verifikimit fizik të mjeteve në adresën e përvcaktuar nga OE, por autoriteti juaj kontraktor nuk ka bërë asnjë verifikim fizik të mjeteve. Të gjitha të dhënat teknike të mjeteve, të cilat shoqëria jonë ka paraqitur në tender, janë të përcaktuara në dokumentacionin e paraqitur nga ana jonë në tender, në kontratën e porosisë me Autovizion sh.a. nr. 581 rep datë 26.09.2017, në të cilën përcaktohen qartë të gjitha mjetet e kërkuara në dst, sipas specifikimeve teknike të kërkuara dhe ku përcaktohet qartë në nenin 1 se “këto mjete do të përdoren nga Victoria Invest për kryerjen e shërbimit me objekt “Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana III”. Në dst përcaktohet se mjetet e kërkuara në pikën 11 të kriterëve të vecanta të kualifikimit, duhet të shoqërohen me akt pronësie original, kontratë qeraje shoqëruar me dokumentacionin përkatës, ose kontratë porosie dhe shoqëria jonë ka paraqitur të gjitha mjetet e kërkuara me kontratë porosie shoqëruar me të dhënat e sakta në lidhje me tipin e mjetit të porositur, vitin e prodhimit të tij, të dhënat teknike për mjetin, kushtet e kontratës si dhe afatin për ekzekutimin e porosisë dhe me katalogun e mjeteve të porositur.

Kjo arsye e juaja nuk qëndron.

II.

Nga ana jonë janë paraqitur mjetet që plotësojnë kërkesat e dst, ju nuk keni kërkuar pronësinë e mjeteve pasi një subjekt që tregëton mjete dhe ka kontratë me neve për këtë qëllim, ju mund të na skualifikoni nëse ky subjekt nuk do të kryente furnizimin brenda datës së kërkuar nga AK në DST, pra ju mund të bënit verifikimin në terren të mjeteve. Kjo arsye nuk qëndron pasi kemi një kontratë shitje me kusht (kontratë furnizimi) edhe sikur të ishte sic thoni ju nuk është e nevojshme nga subjekti shitës pronësia mbi mjetet. Në dst pika 12 e kriterëve të vecanta të kualifikimit, përcaktohet qartë se pronësia mbi mjetet kërkohet në rastet kur OE paraqet mjete në pronësi ose me qera. Kjo arsye skualifikimi nuk qëndron.

III.

Ju sqarojmë si më poshtë vijon: Në DST kërkohen: “Mjetet e porositura duhet të shoqërohen me Akt Marrëveshjen e porosisë/Kontratën e Porosisë (origjinal ose kopje e noterizuar). Akt Marrëveshja e porosisë/Kontrata e porosisë duhet të përmbajë të dhënat e sakta në lidhje me tipin e mjetit të porositur, vitin e prodhimit të tij, të dhënat teknike për mjetin, kushtet e kontratës si dhe afatin për ekzekutimin e porosisë. Akt Marrëveshja e porosisë/Kontratata e Porosisë duhet të shoqërohet dhe me katalogun e mjetit të porositur (origjinal ose kopje e noterizuar)”. Makinat/mjetet e kërkuara në dst ofrohen në mënyrë të tillë nga “Autovision” (IVECO spa), dhe ne kemi paraqitur kontratë me subjektin e specializuar që ka ekskluzivitetin në R.SH të shoqërisë së prodhimit të makinave Iveco spa, i cili merr përsipër të na furnizojë me mjetet sipas specifikimeve teknike të kërkuara prej jush në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë janë paraqitur katalogët, pasi kokës së mjeteve sipas koncensionarit mund ti vendoset cdo lloj karrocierie nga prodhuesi i makinave/mjeteve, që duhen sipas kërkesave në rastin konkret sipas specifikimeve tuaja. Për më tepër që kontrata e porosisë me Autovizion sha nr. 581 rep datë 26.09.2017 ka të specifikuar shumë qartë të gjitha specifikimet teknike të mjeteve sipas kërkesës së dst dhe bashkangjitur janë katalogët e mjeteve të shoqërisë Iveco spa. Në katalogët bashkangjitur kontratës nr. 581 rep datë 26.09.2017 janë të pasqyruara qartë mjetet me specifikimet teknike dhe me material viziv për të gjitha mjetet e kërkuara në dst pika 11 (a-f). Kjo arsye skualifikimi nuk qëndron.

IV.

Nga ana jonë janë paraqitur mjetet që plotësojnë kërkesat e dst dhe argumenti që ju paraqisni nuk qëndron, pasi mjetet mund të jenë njësoj apo të njëjtës markë kjo nuk do të thotë që këto mjete i disponon vetëm një koncensionar apo subjekt, cilido subjekt i licensuar mund të tregtojë mjete të markave/llojeve të njëjta, të cilat normalisht kanë të njëjtat pamje, sepse një lloj mjeti teknologjik nuk mund të ketë pamje të ndryshme visive. Kjo arsye skualifikimi e juaja është e pakuptimtë dhe e paligjshme. Prandaj po ju ritheksojmë se kjo arsye skualifikimi nuk qëndron.

V.

Shoqëria jonë ka qenë pjesëmarrëse në të treja procedurat e prokurimit të pastrimit (zonat Tirana II, Tirana III, Tirana IV) të shpallura prej jush dhe kemi plotësuar numrin e mjeteve në total për të treja procedurat, për më tepër ju si AK nuk keni kërkuar specifikimin për procedurë.

Në një kohë kur ne kemi paraqitur në total mjetet për të treja procedurat ju nuk mund të na skualifikoni me këtë arsye fiktive. “përcaktimi i objektit të procedurës së prokurimit” kërkohej në dst vetëm për mjetet e marra me qera (pika 12/b e kriterëve të veçanta të kualifikimit) dhe në këtë rast kontrata të cilës juve i referoheni me subjektin “Gentek Lojistik termizlik Makin eve Endustriyel Urunler A.S”, Nr. 588. Rep datë 27.09.2017 nuk është kontratë qeraje. Kjo arsye skualifikimi nuk qëndron.

AK Bashkia Tiranë nga njëra anë skualifikon shoqërinë tonë me arsye të paqena, por nga ana tjetër kualifikon operatorë ekonomikë të tjerë. Shoqëria jonë kërkon të dijë se: A ka vlerësuar me të njëjtin qëndrim KVO edhe ofertat, mjetet e shoqërisë tjetër të cilën juve i keni kualifikuar? Apo keni mbajtur dy standarte vlerësimi. Po ju ritheksojmë që: Shoqëria Victoria Invest shpk ka plotësuar të gjitha kriteret për kualifikim të vendosura në DST dhe të përcaktuara në LPP. Arsyeja e skualifikimit të shoqërisë Victoria Invest shpk janë totalisht të kundraligjshme dhe jo në përputhje me ligjin e prokurimeve dhe VKM për Rregullat e Prokurimit Publik. Nga ana juaj është kualifikuar operatori me cmim më të lartë financiar duke i shkaktuar buxhetit të bashkisë edhe një dëm financiar prej 18.645.775 lekë të reja. Përfundimisht kërkojmë kualifikimin e shoqërisë “Victoria Invest” sh.p.k. në tenderin me objekt “Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana III”.

II.4.2. Në datën 01.11.2017, me shkresën nr. 38927/2 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues, duke mos e pranuar ankesën e tij.

II.4.3. Në datën 10.11.2017, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik ku ngrihen të njëjtat pretendime si edhe në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.5. Nëpërmjet shkresës nr. 41344/1 prot., datë 15.11.2017, protokolluar me tonën në datën 16.11.2017, dhe shkresës nr. 41694/1 prot., datë 17.11.2017, protokolluar me tonën në datën 20.11.2017, me objekt “Dërgim informacioni në lidhje me zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt: “Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana III”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Shpresa” sh.p.k. & “Dion Texnkh A.E.” se arsyet e skualifikimit: “Operatori ekonomik “Shpresa” shpk nuk plotëson pikën 2 të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të tenderit:

“Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të shërbimit të pastrimit për Zonën Tirana – III, i cili duhet të ketë një eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet në fushën e ofrimit të shërbimit të pastrimit shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme: Librezë pune (përkatëse), Diplomë , CV përkatëse, Kontrate pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme). Në rast të mosplotësimit në këtë kontratë të eksperiencës 5 vjeçare të punës së kërkuar më sipër, Drejtuesi Teknik duhet të paraqesë vërtetim lëshuar nga punëdhënësi i mëparshëm për eksperiencën e punës në ofrimin e shërbimit të pastrimit, pasi CV rezulton e panënshkruar nga Drejtuesi Teknik.

• Operatori ekonomik “Shpresa” shpk nuk plotëson pikën 4 të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: “Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar 1 (një) mjek të përgjithshëm dhe duhet të rezultojë në list-pagesat e shoqërisë. Kjo duhet të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve: Kontratë Pune e vlefshme, Urdhër Mjeku, CV, Librezë Pune, Diplomën përkatëse. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të ketë të punësuar 1 (një) mjek të përgjithshëm i cili duhet të rezultojë në list-pagesat e shoqërisë dhe ta vërtetojë me dokumentacionin e mësipërm”, pasi CV rezulton e panënshkruar nga Mjeku i Përgjithshëm”, nuk qëndrojnë, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 7 Formular për Vërtetimin e Kualifikimit/pjesëmarrjes, Kapaciteti teknik, pikat 2 dhe 4, nga autoriteti kontraktor janë përcaktuar kriteret:

- *Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të shërbimit të pastrimit për Zonën Tirana – III, i cili duhet të ketë një eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet në fushën e ofrimit të shërbimit të pastrimit shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:*
 - a) *Librezë pune (përkatëse)*
 - b) *Diplomë*
 - c) *CV përkatëse*
 - d) *Kontrate pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme). Në rast të mosplotësimit në këtë kontratë të eksperiencës 5 vjeçare të punës së kërkuar më sipër, Drejtuesi Teknik duhet të paraqesë vërtetim lëshuar nga punëdhënësi i mëparshëm për eksperiencën e punës në ofrimin e shërbimit të pastrimit.*
- *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar 1 (një) mjek të përgjithshëm dhe duhet të rezultojë në list-pagesat e shoqërisë. Kjo duhet të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve: Kontratë Pune e vlefshme, Urdhër Mjeku, CV, Librezë Pune, Diplomën përkatëse. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të ketë të punësuar 1 (një) mjek të përgjithshëm i cili duhet të rezultojë në list-pagesat e shoqërisë dhe ta vërtetojë me dokumentacionin e mësipërm”*

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik ankimes, rezulton se, është paraqitur dokumenti me emërtimin Kontratë Bashkëpunimi ndërmjet shoqërisë “Shpresa” sh.p.k. dhe shoqërisë “Dion Texnikh A.E.”, nga ku shoqëria “Shpresa” sh.p.k. merr përsipër të kryejë 84% të punëve dhe shoqëria “Dion Texnikh A.E.” sh.p.k. merr përsipër 16% të punëve.

Gjithashtu është paraqitur edhe dokumenti Prokurë e Posaçme, sipas së cilës shoqëria “Shpresa” sh.p.k. është përfaqësuese e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë.

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, konstatohet se, shoqëria “Shpresa” sh.p.k. ka paraqitur për përmbushjen e kriterëve si më sipër cituar, dokumentacionin si më poshtë vijon:

Për drejtuesin teknik SH.J. është paraqitur dokumentacioni: CV, licencë, Diplomë, Librezë Pune, kontratë individuale pune;

Për mjekun e përgjithshëm A.GJ. është paraqitur dokumentacioni: kontratë individuale pune, diplomë, licencë, urdhri i mjekut, librezë pune, CV.

III.1.4. Në nenin 28, pika 5 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.1.5. Në Kreun VII, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”.

Në Kreun VII, pika 2 po këtu, parashikohet: “Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”, ndërsa në pikën 3 parashikohet: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

III.1.6. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur dokumentacion në përputhje me përcaktimet e bëra në dokumentat e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor. Në lidhje me CV e punonjësve, sqarojmë se ky dokument është një akt deklarativ, pra është një vetëdeklarim i bërë nga personi/punonjësi në lidhje me eksperiencat e tij të punës dhe nuk ka asnjë përcaktim ligjor në lidhje me detyrimin e firmosjes/nënshkrimit të CV të punonjësve. Sqarojmë se, kriteri i përcaktuar në dokumentat e tenderit që duhet të paraqitet librezë pune, diplomë, CV, kontratë pune, është përmbushur nga operatori ekonomik ankimues, pasi ai ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar në përputhje me kriterin e përcaktuar në këto dokumenta nga autoriteti kontraktor, parë kjo në këndvështrimin e vlerësimit të të gjitha të dhënave të kërkuara nga ky i fundit. Nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se autoriteti kontraktor duhet të bëjë vlerësimin e ofertave vetëm mbi bazën e kriterëve dhe kërkesave të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe jo mbi kriteret shtesë të papërcaktuara në këto dokumenta.

III.1.8. Gjithashtu, kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik ka në shoqërinë e tij stafin e duhur, me qëllim disponimin e kapaciteteve të nevojshme njerëzore, për realizimin me sukses të kontratës dhe nuk duhet të ketë si qëllim në vetvete për të kapur në gabim operatorin ekonomik me pasojë skualifikimin e tij. Sa më sipër, autoriteti kontraktor, duhet të udhëhiqet nga parimi i mirëpërdorimit të fondeve publike dhe përfitimi i një shërbimi me cilësi të mirë dhe me çmim më të ulët, si edhe nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale, aq më tepër në kushte kur kemi një përcaktim të qartë të kriterëve dhe dokumentacionit që duhet të paraqitet, dokumentacion ky i cili provohet më së miri se operatori ekonomik ankimues e disponon.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në këtë procedurë prokurimi, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm, ndaj oferta e këtij operatori nuk duhet të ishte skualifikuar nga ana e autoritetit kontraktor.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Shpresa” sh.p.k. & “Dion Texnkh A.E.” se arsyeja e skualifikimit: *“Operatori ekonomik “Shpresa” shpk nuk plotëson pikën 12, gërma “e” të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: “Mjetet e porositura duhet të shoqërohen me Akt Marrëveshjen e porosisë/Kontratën e Porosisë (origjinal ose kopje e noterizuar).*

Akt Marrëveshja e porosisë/Kontrata e Porosisë duhet të përmbajë të dhënat e sakta në lidhje me tipin e mjetit të porositur, vitin e prodhimit të tij, të dhënat teknike për mjetin, kushtet e kontratës si dhe afatin për ekzekutimin e porosisë. Akt Marrëveshja e porosisë/Kontrata e Porosisë duhet të shoqërohet dhe me katalogun e mjetit të porositur (origjinal ose kopje e noterizuar)", pasi për mjetet e porositura nëpërmjet kontratës së porosisë me subjektin "Autovision" (IVECO), Nr. 6190.Rep, Nr.3056. Kol, datë 17.09.2017 në katalogët e paraqitur jepen të dhëna vetëm për kokën e makinerive dhe jo pjesën e karrocërisë së tyre, pra materiali viziv i paraqitur nuk përmban të dhëna teknike/specifikimet cka bie në kundërshtim me pikën 11 (a-f), nuk qëndron, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 7 Formular për Vërtetimin e Kualifikimit/pjesëmarrjes, Kapaciteti teknik, pikat 12 gërma "e", nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar kriteri :
"Mjetet e porositura duhet të shoqërohen me Akt Marrëveshjen e porosisë/Kontratën e Porosisë (origjinal ose kopje e noterizuar). Akt Marrëveshja e porosisë/Kontrata e Porosisë duhet të përmbajë të dhënat e sakta në lidhje me tipin e mjetit të porositur, vitin e prodhimit të tij, të dhënat teknike për mjetin, kushtet e kontratës si dhe afatin për ekzekutimin e porosisë. Akt Marrëveshja e porosisë/Kontrata e Porosisë duhet të shoqërohet dhe me katalogun e mjetit të porositur (origjinal ose kopje e noterizuar)".

Në dokumentat e tenderit Shtojca 7, pika 11 është përcaktuar kriteri:

1. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme:*
 - a) *Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 10-12 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se 6 (gjashtë) copë;*
 - b) *Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 5-7 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak 4 (katër) copë;*
 - c) *Makinë transportuese të kontenerëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenerëve pa sjellë dëmtimin e tyre, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se 1 (një) copë.*
 - d) *Makinë vetëshkarkuese e hapura nga sipër, me hapje të spondit anësor ose nga pas, të pajisura me mbulesë, për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve vëllimshme dhe të ndërtimit dhe mirëmbajtje të pikave gjatë ditës, etj; me kapacitet transportues 3.5 ton dhe volum vaske jo më të vogël se 5 m³. Viti i prodhimit jo më poshtë se 2010. Jo më pak se 3 (tre) copë;*
 - e) *Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, me kapacitet mbajtës 4-6 m³, të pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe dhjathtas) dhe një fshesë qendrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se 1 (një) copë;*
 - f) *Makina për larjen e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10000 litra ujë, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010 jo më pak se 2 (dy) copë.*

III.2.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik ankimues, rezulton se, është paraqitur dokumenti me emërtimin Kontratë Bashkëpunimi ndërmjet shoqërisë “Shpresa” sh.p.k. dhe shoqërisë “Dion Texnikh A.E.”, nga ku shoqëria “Shpresa” sh.p.k. merr përsipër të kryejë 84% të preventivit dhe shoqëria “Dion Texnikh A.E.” sh.p.k. merr përsipër 16% të punimeve. Gjithashtu është paraqitur edhe dokumenti Prokurë e Posaçme, sipas së cilës shoqëria “Shpresa” sh.p.k. është përfaqësuese e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë.

III.2.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, konstatohet se, shoqëria “Shpresa” sh.p.k. ka paraqitur për përmbushjen e kriterëve si më sipër cituar, referuar kriterit të skualifikimit, dokumentacionin si më poshtë vijon:

Akt marrëveshje porosie ndërmjet shoqërisë “Autovizion” sh.a. në cilësinë e të porositurit dhe shoqërive “Shpresa” sh.p.k. dhe “Dion Texnikh A.E.” si bashkim operatorësh ekonomikë në cilësinë e të porositurit, në të cilën përcaktohet se makinat e nevojshme teknologjike për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave urbane si dhe shërbimeve mbështetëse, të kërkuara për realizimin e kontratës janë si më poshtë:

- a) *Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 10-12 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se 6 (gjashtë) copë;*
- b) *Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 5-7 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak 4 (katër) copë;*
- c) *Makinë transportuese të kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se 1 (një) copë.*
- d) *Makinë vetëshkarkuese e hapura nga sipër, me hapje të spondit anësor ose nga pas, të pajisura me mbulesë, për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve vëllimshme dhe të ndërtimit dhe mirëmbajtje të pikave gjatë ditës, etj; me kapacitet transportues 3.5 ton dhe volum vaske jo më te vogël se 5 m³. Viti i prodhimit jo më poshtë se 2010. Jo më pak se 3 (tre) copë;*
- e) *Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, me kapacitet mbajtës 4-6 m³, të pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe dhjathtas) dhe një fshesë qendrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se 1 (një) copë;*
- f) *Makina për larjen e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10000 litra ujë, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010 jo më pak se 2 (dy) copë.*

Kompania e shoqërisë “Autovizion” sh.a. merr përsipër [...] të gjitha makineritë teknologjike që do të përdoren për zbatimin e kësaj kontrate janë në përputhje me të dhënat teknike dhe specifike të përcaktuara në kapitullin “Specifikimet teknike”, pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit.

Gjithashtu, në këtë akt marrëveshje janë të përcaktuar kushtet e lidhjes së saj dhe mënyra e afati i ekzekutimit.

Kjo akt marrëveshje porosie është e shoqëruar me katalogët përkatës të mjeteve që do të vihen në dispozicion për këtë procedurë prokurimi, në të cilët janë të detajuar edhe të dhënat dhe elementët specifikë përkatës për secilën markë dhe kategori mjeti.

Gjithashtu, në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se kjo shoqëri ka paraqitur dokumentacion si më poshtë:

- Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku janë përcaktuar mjetet që do të jenë në dispozicion për kryerjen e këtij shërbimi;
- Deklaratë mbi mjetet ku përcaktohet se autoriteti kontraktor rezervon të drejtën për verifikimin fizik në parkingun e shoqërisë për të gjitha mjetet sipas akt marrëveshjes së porosisë dhe sipas specifikimeve teknike të deklaruara në procedurën e prokurimit.
- Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike
- Deklaratë nga shoqëria “Autovizion” sh.a. ku deklarohet katalogu përkatës dhe përcaktimi se cilës makineri teknologjike me specifikimet përkatëse të kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, i përket ky katalog (janë cituar 6 lloje katalogesh)
- Katalogjet të markave sipas përcaktimit të bërë në deklaratën e shoqërisë “Autovizion” sh.p.k.
- Katalogje të markës Iveco, përveç atyre të cituara në deklaratë

III.2.4. Në nenin 28, pika 5 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.*

III.2.5. Në Kreun VII, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1 e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”.*

Në Kreun VII, pika 2 po këtu, parashikohet: *“Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”, ndërsa në pikën 3 parashikohet: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.*

III.2.6. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.2.7. Nga sa më sipër analizuar, në lidhje me dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, rezulton se, referuar kërkesës së përcaktuar në pikën 12 gërma “e” të dokumentave të tenderit, nga ky i fundit është paraqitur i gjithë dokumentacioni në përputhje me këtë përcaktim.

Nga verifikimi i dokumentave të tenderit, rezulton se në shtojcën 7, janë përcaktuar kriteret e përgjithshme dhe kriteret e veçanta për kualifikim, nga ku evidentohet të jetë përcaktuar vetëm kriteri që akt marrëveshja e porosisë duhet të shoqërohet me katalogun e mjetit të porositur dhe në asnjë rast nuk është përcaktuar ndonjë kërkesë në lidhje me faktin që katalogu i dorëzuar të ketë të përcaktuar specifikimet teknike të detajuara me të gjithë elementët që autoriteti kontraktor do të konsideronte të nevojshme për t’u paraqitur.

III.2.8. Nga verifikimi i dokumentacionit të ofertës së operatorit ekonomik ankimues, konstatohet se së bashku me ofertën e tij janë paraqitur disa dokumenta si deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike”, shtojcë kjo e detyrueshme për t’u plotësuar nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi, deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku janë përcaktuar mjetet që do të jenë në dispozicion për kryerjen e këtij shërbimi; deklaratë mbi mjetet ku përcaktohet se autoriteti kontraktor rezervon të drejtën për verifikimin fizik në parkingun e shoqërisë për të gjitha mjetet sipas akt marrëveshjes së porosisë dhe sipas specifikimeve teknike të deklaruara në procedurën e prokurimit; deklaratë nga shoqëria “Autovizion” sh.a. ku deklarohet katalogu përkatës dhe përcaktimi, se cilës makineri teknologjike me specifikimet përkatëse të kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, i përket ky katalog (janë cituar 6 lloje katalogjesh); katalogje të markave sipas përcaktimit të bërë në deklaratën e shoqërisë “Autovizion” sh.p.k.; katalogje të markës Iveco, përveç atyre të cituara në deklaratë.

III.2.9. Operatori ekonomik në ankesën e tij pretendon duke argumentuar se: *“[...] në asnjë pikë nuk është kërkuar që katalogët të kenë detyrimisht materialin viziv të mjetit të porositur apo materialin viziv në katalog të jetë në përputhje me specifikimet teknike. Pretendimi i KVO nuk qëndron pasi katalogët e paraqitur përmbajnë të dhëna teknike për secilin mjet të porositur ku jepet gjatësia, gjerësia, pesha maksimale, e ngarkesës etj. Ky format katalogësh është standard dhe u vihet në dispozicion vetëm distributorëve të autorizuar të IVECO që në këtë rast është shoqëria “Autovizion” sh.a. Sqarojmë se katalogët e paraqitur janë të vetmit katalogë që IVECO disponon për mjetet e reja, të cilët i janë vënë në dispozicion vetëm shoqërisë “Shpresa” sh.p.k. dhe “Dion Texnikh AE” për këtë procedurë prokurimi.*

...Gjithashtu kemi paraqitur 3 katalogë shtesë ku i përmbajnë në mënyrë vizive të gjitha mjetet e kërkuara. Mjafton të hyni në faqen IVECO dhe me emërtimet e secilit katalog Daily, New Stralis, New Eurocargo, New Trakker Hi Land dallohen qartë se kujt mjet i përkasin.

III.2.10. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”* Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... ”*

III.2.11. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit. Në rastin konkret, nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, rezulton se nga autoriteti kontraktor nuk është përcaktuar apo vendosur ndonjë kërkesë specifike në lidhje me katalogun, por është kërkuar thjesht paraqitja e tyre pa ndonjë përcaktim tjetër të veçantë apo specifik, ndaj arsyeja e skualifikimit të dhënë nga ana e tij se në të nuk jepen të detajuara të gjitha të dhënat në lidhje me mjetet nuk qëndron, dhe një kriter i pakërkuar në dokumentat e tenderit nuk duhet të përbëjë shkak për skualifikimin e një operatori ekonomik. Autoriteti kontraktor duhet të bëjë vlerësimin e ofertave mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në dokumentat e tenderit, duke përjashtuar këtu vlerësimin mbi dokumenta shtesë të pakërkua nga autoriteti kontraktor, të cilat për më tepër janë paraqitur nga operatori ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit. Për pasojë, gjykojmë se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentat e tenderit e, rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Në rastin në shqyrtim, në kushtet kur nga ana e autoritetit kontraktor nuk është kërkuar specifikisht elementi që duhet të përmbajë katalogu, përmbushja e specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentat e tenderit provohet nëpërmjet dorëzimit të shtojcës 5 deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, deklaratave mbi disponueshmërinë e mjeteve, deklaratave mbi rezervimin e të drejtës së autoritetit për të bërë verifikim, si edhe katalogjeve të paraqitura.

III.2.12. Akoma më tej, edhe pse autoriteti kontraktor nuk ka përcaktuar ndonjë kriter specifik në lidhje mbi mënyrën se si duhej të paraqiteshin katalogët apo çfarë të dhënash duhet të përmbanin ata, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, katalogët e paraqitur janë të bëra nga prodhuesi i mjeteve, dhe si të tilla nuk mund të modifikohen apo ndryshohen, pra nuk mund të ndërhyhet dhe ndryshohet duke përcaktuar dhe vendosur edhe të dhëna të tjera të detajuara të një mjeti.

Neni 53 i ligjit për prokurimin publik, përcakton shprehimisht se: *“Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 dhe 33 të këtij ligji, nuk duhet të kërkohej, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme”*. Në rastin konkret, kur edhe oferta e paraqitur është me çmim më të ulët dhe me leverdi ekonomike, duke kursyer buxhetin e shtetit në një vlerë të konsiderueshme, autoriteti kontraktor nuk mund të skualifikojë operatorin ekonomik pa marrë edhe sqarimet përkatëse, aq më tepër në kushtet kur, mjetet e ofruara mund të verifikohen edhe në faqen përkatëse zyrtare referuar markës së tyre.

Katalogu i një pajisje hartohet nga kompania prodhuese e pajisjes dhe përfshin në vetvete të gjithë elementët kryesorë të saj.

III.2.13. Gjithashtu, nga ana tjetër, operatori ekonomik ka nënshkruar deklaratën e përmbushjes së specifikimeve teknike, ku deklarohet plotësimin e të gjitha specifikimeve teknike, duke marrë përsipër nën përgjegjësinë e tij përmbushjen e këtyre të fundit, ka nënshkruar një sërë deklaratash, ku deklarohet llojin e mjetit duke e specifikuar me mjetin e kërkuar në dokumentat e tenderit, deklaratë ku i jep të drejtën autoritetit për të bërë verifikimin në vend të mjetit dhe aq më tepër ka dorëzuar edhe katalogët (një numër të konsiderueshëm të tyre), nga ku konstatohen të dhëna dhe elementët specifikë të përshkruar në to në lidhje me mjetet.

Sqarojmë se autoriteti kontraktor, nëse ka paqartësi, bazuar edhe në përcaktimet në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, duhet të kërkojë sqarime të mëtejshme, në rastet kur kemi të bëjmë me elemente të paqarta, me qëllim shmangien e skualifikimit me të padrejtë të një operatori ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

III.2.14. KPP sqaron se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

II.2.15. Gjithashtu, kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik disponon mjete me parametrat e kërkuar, me qëllim funksionimin normal të tyre, si edhe për të kryer edhe funksionin për të cilin do të merren.

Sa më sipër, autoriteti kontraktor, duhet të udhëhiqet nga parimi i mirëpërdorimit të fondeve publike dhe përfitimi i një produkti me cilësi të mirë dhe me çmim më të ulët, si edhe nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale, aq më tepër në kushte kur kemi një përcaktim të qartë të kriterëve dhe dokumentacionit që duhet të paraqitet, dokumentacion ky i cili provohet më së miri se operatori ekonomik ankimes e disponon.

Autoriteti kontraktor duhet të bëjë vlerësimin e ofertave mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, referuar nenit 53, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, në të cilin përcaktohet se "*Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave [...]*", si edhe referuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, neni 66, autoriteti kontraktor në rastin konkret, nëse do të kishte dyshime apo do të ishte i paqartë, kishte të drejtë që të kërkonte sqarime apo të bënte verifikimet përkatëse, në mënyrë që të bënte një vlerësim të saktë dhe trajtim të barabartë dhe jo diskriminues të operatorëve ekonomikë.

Sa më sipër analizuar, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues përmbush kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

III.2.16. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, në bazë të nenit 62 “Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës” të LPP, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetë cilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje se, referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e mallit/shërbimit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të nenin 62 të LPP-së, si më sipër cituar.

III.2.17. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në këtë procedurë prokurimi, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm, ndaj oferta e këtij operatori nuk duhet të ishte skualifikuar nga ana e autoritetit kontraktor.

Sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, përse i përket operatorit ekonomik të kualifikuar, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se operatori ekonomik ankimues ka ofertuar me vlerë më të ulët ekonomike kundrejt operatorit tjetër ekonomik për të cilin paraqet pretendime për kualifikimin e padrejtë të tij, dhe në kushtet kur gjendja faktike e juridike e operatorit ekonomik ankimues do të ndryshojë duke vijuar e kualifikuar, rrjedhimisht ky operator ekonomik nuk ka një interes të ligjshëm të ankohet për operatorët e renditur sipër tij, referuar vlerës ekonomike.

Rrjedhimisht, ky pretendim i operatorit ekonomik ankimues nuk do të merret në shqyrtim.

III.4. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik “Victoria Invest” sh.p.k. se arsyeja e skualifikimit: *“Operatori ekonomik “Victoria” shpk nuk plotëson pikën 11 të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme...”, pasi nuk është paraqitur një deklaratë mbi disponueshmërinë ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë e mjeteve të kërkuara”, nuk qëndron, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.4.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 7 *Formular për Vërtetimin e Kualifikimit/pjesëmarrjes*, Kapaciteti teknik, pika 11, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme:

- g) *Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 10-12 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se 6 (gjashtë) copë;*
- h) *Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 5-7 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak 4 (katër) copë;*
- i) *Makinë transportuese të kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundur ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se 1 (një) copë.*
- j) *Makinë vetëshkarkuese e hapura nga sipër, me hapje të spondit anësor ose nga pas, të pajisura me mbulesë, për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve vëllimshme dhe të ndërtimit dhe mirëmbajtje të pikave gjatë ditës, etj; me kapacitet transportues 3.5 ton dhe volum vaske jo më të vogël se 5 m³. Viti i prodhimit jo më poshtë se 2010. Jo më pak se 3 (tre) copë;*
- k) *Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, me kapacitet mbajtës 4-6 m³, të pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe djathtas) dhe një fshesë qendrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se 1 (një) copë;*
- l) *Makina për larjen e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10000 litra ujë, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010 jo më pak se 2 (dy) copë.*

III.4.2. Operatori ekonomik ankimues në lidhje me këtë arsye skualifikimi pretendon se: “Shoqëria jonë ka paraqitur në tender të gjithë dokumentacionin e kërkuar në DST, ka paraqitur gjithashtu deklaratën për specifikimet teknike dhe gjithashtu deklaratë për kontrollin e mjeteve me specifikimet përkatëse nga momenti i shpalljes së fituesit. Në deklaratën e paraqitur në tender nga ana e shoqërisë tonë i kemi dhënë të drejtë AK që të verifikojë disponueshmërinë e mjeteve gjatë verifikimit fizik në çdo moment të kërkuar në AK, madje kemi deklaruar edhe adresën e saktë të vendndodhjes së mjeteve. Disponueshmërinë e mjeteve AK të të gjithë operatorëve ekonomikë, AK ka të drejtën ta bëjë gjatë verifikimit fizik të mjeteve në adresën e përvcaktuar nga OE, por autoriteti juaj kontraktor nuk ka bërë asnjë verifikim fizik të mjeteve. Të gjitha të dhënat teknike të mjeteve, të cilat shoqëria jonë ka paraqitur në tender, janë të përcaktuara në dokumentacionin e paraqitur nga ana jonë në tender, në kontratën e porosisë me Autovizion sh.a. nr. 581 rep datë 26.09.2017, në të cilën përcaktohen qartë të gjitha mjetet e kërkuara në dst, sipas specifikimeve teknike të kërkuara dhe ku përcaktohet qartë në nenin 1 se “këto mjete do të përdoren nga Victoria Invest për kryerjen e shërbimit me objekt “Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana III”. Në dst përcaktohet se mjetet e kërkuara në pikën 11 të kriterëve të vecanta të kualifikimit, duhet të shoqërohen me akt pronësie original, kontratë qeraje shoqëruar me dokumentacionin përkatës, ose kontratë porosie dhe shoqëria jonë ka paraqitur të

gjitha mjetet e kërkuara me kontratë porosie shoqëruar me të dhënat e sakta në lidhje me tipin e mjetit të porositur, vitin e prodhimit të tij, të dhënat teknike për mjetin, kushtet e kontratës si dhe afatin për ekzekutimin e porosisë dhe me katalogun e mjeteve të porositur”.

III.4.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik ankimues, rezulton se, në sistemin e prokurimeve elektronike nuk është paraqitur asnjë dokument në lidhje me kriterin për deklaratën me shkrim të disponueshmërisë së mjeteve, fakt ky i pranuar edhe nga vetë operatori ekonomik ankimues, i cili citon se nuk është paraqitur një deklaratë e tillë duke argumentuar se nuk është e domosdoshme paraqitja e këtij dokumenti.

III.4.4. Në nenin 28, pika 5 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.*

III.4.5. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.*

III.4.6. Kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, makineritë, pajisjet dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi. Dokumenti deklaratë me shkrim ku të jenë të përcaktuara të gjitha të dhënat teknike të mjeteve, sasitë përkatëse të tyre mungon dhe nuk është paraqitur në ofertën e operatorit ekonomik ankimues në sistemin e prokurimeve elektronike. Rezulton se në përmbushje të kriterit të sipërcituar, nga ana e operatorit ekonomik ankimues nuk është paraqitur asnjë dokumentacion i tillë, kërkesë kjo e përcaktuar në kriteret e veçanta për kualifikim nga autoriteti kontraktor dhe e detyrueshme për t’u plotësuar nga operatorët ekonomikë.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

Mungesa qoftë edhe i një kriterit të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Operatori ekonomik ankimues duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve para hapjes së ofertave. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet si i vlefshëm.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.5. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik “Victoria Invest” sh.p.k. se arsyeja e skualifikimit: *“Operatori ekonomik “Victoria” shpk nuk plotëson pikën 12, të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: “Për Mjetet teknologjike të kërkuara në pikën 11, gërma a – f, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë.....”, pasi në dokumentacionin bashkëlidhur kontratës së shitjes me kusht me subjektin “Gentek Lojistik temizlik Makin eve Endustriyel Urunler A.S”, nuk ekziton asnjë lidhje pronësie mbi mjetet nga ana e shitësit, subjektit “Gentek Lojistik temizlik Makin eve Endustriyel Urunler A.S”, nuk qëndron, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.5.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 7 *Formular për Vërtetimin e Kualifikimit/pjesëmarrjes, Kapaciteti teknik, pika 12, gërma “e”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:*

Mjetet e porositura duhet të shoqërohen me Akt Marrëveshjen e porosisë/Kontratën e Porosisë (origjinal ose kopje e noterizuar). Akt Marrëveshja e porosisë/Kontrata e Porosisë duhet të përmbajë të dhënat e sakta në lidhje me tipin e mjetit të porositur, vitin e prodhimit të tij, të dhënat teknike për mjetin, kushtet e kontratës si dhe afatin për ekzekutimin e porosisë. Akt Marrëveshja e porosisë/Kontrata e Porosisë duhe të shoqërohet dhe me katalogun e mjetit të porositur (origjinal ose kopje e noterizuar).

III.5.2. Operatori ekonomik ankimues pretendon se: *“Nga ana jonë janë paraqitur mjetet që plotësojnë kërkesat e dst, ju nuk keni kërkuar pronësinë e mjeteve pasi një subjekt që tregëton mjete dhe ka kontratë me neve për këtë qëllim, ju mund të na skualifikoni nëse ky subjekt nuk do të kryente furnizimin brenda datës së kërkuar nga AK në DST, pra ju mund të bënit verifikimin në terren të mjeteve. Kjo arsye nuk qëndron pasi kemi një kontratë shitje me kusht (kontratë furnizimi) edhe sikur të ishte sic thoni ju nuk është e nevojshme nga subjekti shitës pronësia mbi mjetet. Në dst pika 12 e kriterëve të vecanta të kualifikimit, përcaktohet qartë se pronësia mbi mjetet kërkohet në rastet kur OE paraqet mjete në pronësi ose me qera. Kjo arsye skualifikimi nuk qëndron”.*

III.5.3. Autoriteti kontraktor në lidhje me këtë arsye skualifikimi argumenton se: *“Nga verifikimi i dokumentacionit vërehet se për kontratën e porosisë me subjektin “Gentek Lojistik temizlik Makin eve Endustriyel Urunler A.S.” përveç fotove identike me ato të paraqitura në kontratën tjetër të porosisë me subjektin “Autovizion” (Iveco), nuk është bashkëngjitur asnjë e dhënë tjetër teknike, asnjë specifikim teknik. Në kontratën e shitjes me kusht është përcaktuar se subjekti “Gentek Lojistik temizlik Makin eve Endustriyel Urunler A.S.” është licencuar na organet kompetente për tregtimin dhe shërbimet për automjete të modeleve dhe llojeve të ndryshme,*

përfshirë edhe mjetet teknologjike dhe fotot bashkëlidhur kësaj kontrate nuk dëshmojnë as llojin e tyre, as modelin, as të dhënat dhe specifikimet teknike të kërkuara, çka nuk dëshmon për lidhjen midis këtyre mjeteve dhe subjektit “Gentek Lojistik temizlik Makin eve Endustriyel Urunler A.S.”.

III.5.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik ankimues konstatohet se është paraqitur dokumenti Kontratë shitje me kusht, ndërmjet shoqërisë ankimuese dhe “Gentek Lojistik temizlik Makin eve Endustriyel Urunler A.S.”, në të cilën nuk evidentohet ndonjë fakt në lidhje me llojin e mjeteve që ky subjekt disponon, pasi në kontratën e paraqitur ose bashkëlidhur saj, nuk është depozituar asnjë deklaratë apo dokument që të cilësojë llojin e mjetit që disponon kjo shoqëri shitëse, për secilin nga mjetet teknologjike që ka përcaktuar autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Pra, referuar kriterit të përcaktuar në dokumentat e kërkuar është kërkuar qartësisht që akt Marrëveshja e Porosisë/Kontrata e Porosisë duhet të përmbajë të dhënat e sakta në lidhje me tipin e mjetit të porositur, vitin e prodhimit të tij, të dhënat teknike për mjetin, kushtet e kontratës si dhe afatin për ekzekutimin e porosisë, ndërkohë që nga ana e ankimuesit nuk janë paraqitur të dhëna të sakta në lidhje me këtë fakt, duke mos e vërtetuar lidhjen reale të subjektit me të cilin është lidhur kontrata e shitjes dhe mjetet që ai do të japë në dispozicion të shoqërisë “Victoria Invest” sh.p.k. me qëllim realizimin e këtij shërbimi.

III.5.5. Në nenin 28, pika 5 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.*

III.5.6. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.*

III.5.7. Gjithashtu, në rast se operatorit ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesave të mësipërme për kualifikim, ai mund të paraqiste kërkesë për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave të parashikuar nga neni 42 i LPP-së, ku parashikohet se: *“[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.*

Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.

III.5.8. Kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, makineritë, pajisjet dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Mungesa qoftë edhe i një kriterit të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve para hapjes së ofertave.

Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet si i vlefshëm.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.6. Në lidhje me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që nuk i janë pranuar disa prej pretendimeve të tij dhe gjendja faktike e juridike e këtij operatori nuk do të ndryshojë duke mbetur i skualifikuar nga procedura e prokurimit në fjalë, e për rrjedhojë duke mos përmbushur interesat e ankimuesit, ndaj edhe nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.

III.7. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Victoria Invest” sh.p.k. për skualifikimin e operatorit ekonomik të kualifikuar, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se:

III.7.1. Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), me titull “Të drejtat e personit të interesuar” parashikon se: “Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin”.

III.7.2. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë) se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP është i papranueshëm.

Neni 63, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.

Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk ka ndonjë interes të ligjshëm për të mbrojtur.

Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk arrin të realizojë interesin e tij të ligjshëm.

Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (*përkundrejt atij imagjinar*) nuk ka sesi të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Për rrjedhojë, ky pretendim i operatorit ekonomik ankimues nuk merret në shqyrtim, pasi operatori ekonomik ankimues nuk legjitimohet.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranohet ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Shpresa” sh.p.k. & “Dion Texnikh A.E.” në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me nr. REF-21386-07-18-2017, me objekt “*Shërbimi i pastrimit të zonës Tirana III*”, me fond limit 494.683.652 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 27.09.2017 nga autoriteti kontraktor, Bashkia e Tiranës.
2. Të mos pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Victoria Invest” sh.p.k. në procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor të anulohet vendimin e KVO-së për skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Shpresa” sh.p.k. & “Dion Texnikh A.E”, si dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë bashkim operatorësh ekonomikë.

4. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijëni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
6. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar bashkimi i operatorëve ekonomikë “Shpresa” sh.p.k. & “Dion Texnikh A.E.”.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1665 Protokolli
Datë 08.11.2017

Nr. 1675 Protokolli
Datë 10.11.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha